Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Sociologjisë

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: Migrim

"Emigrimi potencial i studentëve të qytetit të Tiranës"

Punoi: Romina Lama

Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore në Master Shkencor

Tiranë 2021

HYRJE

Me rritjen e shpejtë të arsimimit ndërkombëtar, gjithnjë e më shumë studentë po kërkojnë shkollim të lartë në vende të huaja dhe shumë studentë ndërkombëtarë tani e konsiderojnë studimin jashtë shtetit, si një gur themeli drejt qëndrimit të përhershëm brenda një vendi ("Student migration," n.d.). Migrimi është një proces kompleks, pjesë e transformimeve më të gjera socio-ekonomike (Vullnetari, 2012). Ballkani Perëndimor ka shumë gjasa të mbetet një eksportues i njerëzve të arsimuar për vitet në vijim – brenda një dinamike migracioni që do kontrollohet nga vendet e destinacionit (Vracic, 2018). Që nga viti 1990, Shqipëria ka përjetuar një nga ritmet më të mëdha dhe më të shpejta në rritje të migracionit ndërkombëtar, në historinë e kohëve të fundit të Europës (Gjonca et al., 2008). Emigrimi, pas tre dekadash, po vazhdon ende në Shqipëri, ndonëse me një karakter të ndryshuar – më pak një migrim varfërie, dëshpërimi dhe proteste, siç ishte në vitet 1990 dhe më shumë një tipar strukturor i shoqërisë dhe demografisë shqiptare, veçanërisht midis shtresave më të reja dhe më të arsimuara të popullsisë (King & Gëdeshi, 2020). Migrimi i profesionistëve dhe teknikëve nga vendet më të varfra në botën e zhvilluar ka marrë vëmendje të konsiderueshme nga qeveritë, industria dhe akademia, më pak për shkak të numrit të emigrantëve të përfshirë, sesa për shkak të pasojave ekonomike dhe kulturore të flukseve të tilla (Portes & Celaya, 2013). Dr. Ilir Gëdeshi shprehet se fenomeni i emigracionit në Shqipëri ka prekur pjesën më të kualifikuar të vendit dhe jo të papunët (Exit Explains, 2020). Një anketë e vitit 2020 e profesorëve Gëdeshi dhe King, zbuloi se 79% e studentëve shqiptarë dëshirojnë të largohen nga vendi. Nga ana tjetër, 95% e atyre që studiojnë jashtë nuk dëshirojnë të kthehen. Fenomeni pritet të përkeqësohet prej efekteve negative të pandemisë COVID-19 (Monitor, 2021).

Qëllimi i këtij studimi është identifikimi, përshkrimi dhe analizimi i faktorëve kryesorë shtytës dhe tërheqës që i shtyjnë studentët e qytetit të Tiranës, drejt një migrimi, përmasat e këtij emigrimi, vendet potenciale të destinacionit të tyre, planet afatgjata dhe mundësia e rikthimit në Shqipëri në të ardhmen. **Në aspektin e vlerës njohëse dhe të rëndësisë,** ky studim paraqet një ndihmesë modeste të pasqyrimit të emigrimit potencial të studentëve të qytetit të Tiranës. Gjithashtu ky studim nxjerr në pah një fenomen aktual në shoqërinë tonë, duke shpresuar që shumë studime akoma më të mëdha të kryhen në të ardhmen përsa i përket kësaj tematike.

ZHVILLIM

Rritja e dëshirës për emigrim zbulon dobësitë strukturore të ekonomisë dhe politikave, që në vend që të përmirësohen po përkeqësohen dhe nuk po gjenerojnë mundësi dhe perspektivë për popullatën (Monitor, 2021). Studentët, nga ana tjetër, shiheshin (dhe shihen) si migrantë 'të dëshirueshëm' që lëvizin për të pasuruar kapitalin e tyre njerëzor, pas së cilës ata ose do të kthehen në vendet e tyre të origjinës, ose do të qëndrojnë në vendin pritës të zgjedhur, duke kontribuar në tregun e punës atje. Ka shumë arsye të këtij eksodi të madh të studentëve shqiptarë. Këta faktorë përfshijnë papunësinë, pagat e ulëta, mungesën e mundësive për avancim në karrierë, nivelet e larta të korrupsionit, cilësinë e ulët të kujdesit shëndetësor, cilësinë e ulët të arsimimit, ndotjen, pasigurinë fizike, mbrojtjen e kufizuar sociale, mungesën e besimit në sistemin e drejtësisë, pakënaqësinë me politikën etj. Sipas të dhënave të UNESCO-s, studentët shqiptarë janë të pranishëm në mbi 30 vende, por dhjetë vendet e para që zgjedhin për të studiuar janë: Italia, Greqia, Turqia, Gjermania, SHBA-ja, Franca, Austria, Rumania, Britania e Madhe, dhe Bullgaria. Ndërkohë, numri i studentëve shqiptarë në Gjermani është rritur me shpejtësi vitet e fundit. Zhvillimi i avancuar ekonomik dhe social, mundësitë e mira punësimi për personat me arsim të lartë dhe personat e kualifikuar, niveli i lartë i arsimit terciar, tarifat e ulëta universitare dhe ekzistenca e një komuniteti shqiptar gjithnjë e në rritje, janë disa nga faktorët kryesorë që shpjegojnë ndryshimin e preferencës së destinacionit nga Italia në Gjermani (King & Gëdeshi, 2020). Është migrimi 'elitar' akademikët, shkencëtarët dhe profesionistët e tjerë që largohen nga Shqipëria në kërkim të kushteve më të mira të punës dhe arritjeve profesionale (Vullnetari, 2012). Vendimet e migrantëve shumë të aftë për t'u larguar nga vendet e tyre të origjinës, lidhen me vlerësimin e një sërë faktorësh tërheqës dhe shtytës. Punët, pritshmëritë për paga më të larta, kushte më të mira pune, trajnime etj., i tërheqin migrantët, ndërsa mungesa e mundësive për

punë, pagat e ulëta, cilësia e ulët e shërbimeve publike bazë, format politike dhe të tjera të shtypjes dhe konflikti etj., i shtyjnë migrantët të largohen (Mortensen, 2008). Studimet kanë treguar se jo të gjitha pasojat e migrimit në zonat e origjinës mund të interpretohen si negative. Ndërsa më të arsimuarit mund të largohen nga një komunitet, migrantët dërgojnë para (remitanca). Emigrantët mund të mësojnë gjithashtu aftësi kur janë në zonat e destinacionit, të cilat më vonë mund të përdoren nëse kthehen (Skeldon, 2009). Anëtarësimi në BE nuk do të ndalonte, por madje mund të përkeqësonte ikjen e trurit (Vracic, 2018). Ikja e trurit është një fenomen ku, në krahasim me popullsinë e mbetur, emigrojnë një numër i konsiderueshëm i personave më të arsimuar ("Human capital flight," n.d.). "Ikja e trurit", është përcaktuar tradicionalisht si një humbje neto për vendet që shpenzojnë burime të pakta duke ofruar trajnime të avancuara për qytetarët e tyre, vetëm për t'i humbur ata jashtë vendit (Portes & Celaya, 2013). Përsa i përket aspektit gjinor, një nga arsyet kryesore të migrimit për gratë ka qenë bashkimi familjar pas migrimit për motive punësimi të partnerit mashkull (Ortensi, 2015). Tendenca e lartë e emigrimit potencial, mund të rrisë mungesat në segmentin e disa profesioneve shumë të nevojshme në Shqipëri, sidomos në mjekësi, thotë Gëdeshi (Monitor, 2021). Emigracioni në nivele të larta i njerëzve të arsimuar nga vendi do të varfërojë ekonominë dhe gjithashtu ndikon negativisht në rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit – thotë një studim i ekspertëve të INSTAT, Elma Çali dhe Sokrat Palushi (AgroWeb, 2021). Ervin Goci, pedagog në departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës, shprehet se ky fenomen nuk është thjesht pakënaqësi, por është depresion social (Elezi, 2019).

Metoda që kam përdorur në këtë studim, është metoda sasiore. Janë realizuar 100 anketa në Google Forms. Është respektuar e drejta e personave të intervistuar për të mbetur anonimë. Në realizimin e studimit, kam hasur disa kufizime: Është më e vështirë të sigurosh përgjigjëdhënës për plotësimin e anketave kur realizohen online sesa, drejtpërdrejtë, për shkak të mungesës së kontakteve me këta persona, që mund t'i sigurosh lehtësisht në një ambjent auditori. Kufizimet e këtij studimi përfshijnë gjithashtu shkallën e përgjigjes. Numri i pjesëmarrësve është një numër i vogël në krahasim me sasinë e të gjithë studentëve shqiptarë. Një kufizim tjetër përfaqësohet nga fakti që mostra ishte jo-probabilistike. Kështu, rezultatet nuk mund të përgjithësohen për të gjithë sistemin e arsimit të lartë shqiptar.

Gjetjet

1. Gjinia: 89.9% femër; 10.1% mashkull; **2. Mosha:** 18 vjeç- 4; 19 vjeç- 4; 20 vjeç- 10; 21 vjeç- 20; 22 vjeç- 33; 23 vjeç- 12; 24 vjeç- 5; 25 vjeç- 3; 26 vjeç-3; 28 vjeç- 3; 32 vjeç- 3; **3.Universiteti, fakulteti: UT, FSHS**-50; **UET**-15; **UT, Fakulteti i Ekonomisë**-14; **UPT**-11; **Universiteti i Mjekësisë**-5; **UST**-5**; 4. Niveli i studimeve tuaja aktualisht:** bachelor viti i parë- 2.9%; bachelor viti i dytë- 1.4%; bachelor viti i tretë- 26.1%; master profesional- 5.8%; master shkencor viti i parë- 8.7%; master shkencor viti i dytë- 55.1%; **5. Vendbanimi:** qytet 75.4%; periferi 14.5%; fshat 10.1%; **6. Banoni në:** shtëpinë tuaj 55.1%; shtëpi me qera 31.9%; konvikt 11.6%; të afërmit 1.4%; **7. Me kë banoni:** me familjen 60.9%; me shok/shoqe 18.8%; vetëm 10.1%; me të afërm të tjerë 5.8%; partner/e 4.3%; **8. A jeni aktualisht në marrëdhënie pune:** jo: 52.2%; po 47.8%; **9. Sa të kënaqur jeni me jetesën në vendin tuaj:** pak i/e kënaqur 43.5%; aspak i/e kënaqur 27.5%; i/e kënaqur 27.5%; shumë i/e kënaqur 1.4%; **10. Cili është plani juaj për të ardhmen:** të punësohem jashtë shtetit 34.8%; të punësohem në Shqipëri 31.9%; të vazhdoj një cikël tjetër studimesh jashtë shtetit 11.6%; të vazhdoj kurse ose trajnime jashtë shtetit

10.1%; të vazhdoj një cikël tjetër studimesh në Shqipëri 7.2%; të vazhdoj kurse ose trajnime në Shqipëri 2.9%; të martohem në Amerikë 1.4%; **11. Cila është arsyeja kryesore e dëshirës tuaj për t'u larguar nga Shqipëria:** arsye ekonomike: mundësitë e punësimit në Shqipëri janë të pakta, kostoja e jetesës është shumë e lartë dhe pagat e ulëta; kushtet e punës nuk janë të mira në Shqipëri (paga, siguria); është e vështirë të gjesh punë në Shqipëri 44.3%; mendoj që nuk kam të ardhme në Shqipëri 21.3%; dëshiroj të krijoj një karrierë ndërkombëtare 6.6%; kërkoj të jetoj në një vend më të sigurt 6.6%; kërkoj arsim më cilësor/të vazhdoj studime të mëvonshme (specializim, master) 3.3%; të bashkohem me familjen, të afërmit, miqtë, partnerin/en; për të shoqëruar/ndjekur partnerin/en, prindin; për t'u martuar, i/e sapo martuar 3.3%; kërkoj të jetoj në një vend ku shërbimi shëndetësor të jetë më cilësor 3.3%; për t'i shpëtuar problemeve familjare 3.3%; kërkoj të jetoj në një vend më të qëndrueshëm nga aspekti politik 1.6%; kërkoj të jetoj në një vend më meritokratik 1.6%; kërkoj të jetoj në një vend ku të drejtat e njeriut respektohen më shumë 1.6%; për të kaluar një aventurë të bukur 1.6%; të gjithë arsyet e lartpërmendura 1.6%; **12. Nëse planifikoni të lëvizni/shkoni jashtë shtetit, në cilin vend mendoni të ikni:** Gjermani; SHBA; Itali; Angli; Zvicër; Suedi; Spanjë; Francë; Britani; Kanada; Austri; Hollandë; Belgjikë; Vendet e BE; Turqi; Kudo, mjafton të jetë jashtë Shqipërisë; **13. Cila është arsyeja kryesore që keni zgjedhur këtë vend:** është vend i fuqishëm nga aspekti ekonomik (ka një treg të zhvilluar pune, ofron shumë mundësi për punësim dhe ka paga të larta) 38.6%; kam familjarë dhe të njohur/afërm atje që do më mbështesin 26.3%; të shoqëroj/ribashkohem me familjen/të shoqëroj/ribashkohem me parterin/en 7%; kam dëgjuar për përvojën pozitive të të tjerëve dhe kërkoj ta provoj vetë 7%; më pëlqen stili i jetesës i atij vendi dhe njerëzit/më pëlqen kultura e atij vendi 5.3%; njoh gjuhën dhe kulturën e atij vendi dhe e kam më të lehtë të përshtatem 5.3%; ofrohet arsim cilësor 3.5%; ofrohet shërbim shëndetësor cilësor 3.5%; është vend që njihet për

mbështetjen sociale/është shtet social 3.5%; kam siguruar bursë për kohën që do të studio atje 0%; kam siguruar një kontratë pune në atë vend 0%; kam jetuar më përpara në atë vend/kam qenë dikur më përpara në atë vend për një vizitë të shkurtër 0%; **14. A keni një plan të caktuar se si do të shkoni jashtë shtetit:** kam të afërm jashtë shtetit që do më ndihmojnë/mbështesin 32.8%; do aplikoj për vizë për arsye punësimi 19%; do aplikoj për vizë për arsye studimi 12.1%; do aplikoj për llotari 12.1%; me anë të bursave shtetërore/shkollore 5.2%; në mënyrë ilegale/të paligjshme/në të zezë 5.2%; do aplikoj për bashkim familjar 5.1%; duke aplikuar në programe si Erasmus ose të tjera të ngjashme 3.4%; do aplikoj për azil 1.7%; duke aplikuar në organizata 1.7%; duke aplikuar për vizë turizmi 1.7%; **15. Cili do të jetë burimi juaj kryesor i financimit për studimet tuaja jashtë shtetit:** do të më mbështesin prindërit 44%; do t'i financoj vetë 22%; kam familje, të afërm, miq etj në vendin pritës 10%; do marr hua në bankë 8%; do të më mbështesi partneri/ja 4%; do të më ndihmojë punëdhënësi 4%; do marr bursë nga shkolla/institucion/organizatë/donator 4%; do të më mbështesin të afërm të tjerë 2%; sugar daddy 2%; do të më mbështesin miqtë 0%; **16. Keni në plan të punësoheni në profesionin tuaj, apo do e ndërroni profesionin:** dëshiroj të punësohem në profesionin tim 80.3%; dëshiroj të punësohem në një profesion tjetër 16.4%; nëse mundet në profesionin tim po, nëse jo në një tjetër 1.6%; do zhvilloj kurse e trajnime 1.6%; **17. Cili është benefiti kryesor që mendoni se do të arrini pasi të emigroni jashtë shtetit:** shtimi/përforëcimi i dijeve të mia akademike dhe profesionale 29.8%; dhënia e një perspektive në lidhje me karrierën time të ardhshme 24.6%; të jetuarit jashtë shtetit 14%; zhvillim dhe maturim personal 10.5%; zhvillimi i një karriere ndërkombëtare 8.8%; mënyra të reja të të menduarit dhe të sjelljes 7%; të gjitha alternativat 1.8%; pothuajse të gjitha alternativat e mësipërme 1.8%; më shumë para 1.8%; aftësim i gjuhës të vendit pritës 0%; njohuri dhe dije për një shtet tjetër 0%; **18. A është në planin tuaj të ktheheni**

në Shqipëri: nuk mendoj të kthehem në Shqipëri 44.6%; do të rikthehem në Shqipëri pas një periudhe punësimi jashtë 37.5%; do rikthehem në Shqipëri për t'u punësuar pasi të përfundoj studimet/trajnimet/kurset 12.5%; nëse do të stabilizohesha dhe do të më pëlqente jetesa jashtë vendit, nuk mendoj se do të kthehesha në Shqipëri 1.8%; nuk e di 1.8%; larg qoftë 1.8%; **19. Cili është plani juaj afatgjatë:** do të ndërtoj një të ardhme në vendin ku dëshiroj të emigroj, duke qëndruar atje përgjithmonë 54.4%; pasi të kem përmbushur synimet/qëllimet e mia, do rikthehem në Shqipëri 35.1%; vendin ku dëshiroj të shkoj do e përdor si vend tranzit, që më pas të shkoj diku tjetër 10.5%; **20. Çfarë duhet ndryshuar/bërë që ju të mos ikni, por të qëndroni në Shqipëri:** Gjithçka; Duhen përmirësuar: Arsimi, Shëndetësia, Politika, Tregu i Punës, Mentaliteti, Drejtësia, Siguria, Pagat; Të shtohen vendet e punësimit, të rriten pagesat, të shtohet siguria në vend, të rritet kualiteti i mjekësisë etj; Punësimi i të rinjve, meritokraci, stimulim i studentëve për të vazhduar të studiojnë, paga më të larta, qëndrueshmëri e siguri, politika; Paga minimale duhet të jetë më e lartë dhe kostoja e jetesës më e ulët, duhet përmirësim në arsim dhe shëndetësi; Çdo gjë në çdo fushë të mundshme; Një cilësi jetese më e mirë si dhe më shumë mundësi punësimi; Rritje page minimale, mundësi punësimi në profesion më të mëdha, përmirësim i sistemit shëndetësor dhe atij arsimor; Të hapen vende pune, të rriten pagat, meritokraci, arsim cilësor dhe me meritë; E gjithë Shqipëria; Thuajse gjithçka nevojitet të ngrihet nga fillimi; Duhen krijuar mundësi punësimi për të rinjtë dhe pagesa të larta, arsim cilësor dhe shërbimet e shëndetësisë të jenë maksimale; Politikat arsimore duke filluar nga cikli i ulët e duke u rritur gradualisht, ka shumë mangësi duke bërë që të humbë meritokracia; Ekonomia, politika dhe emancipimi i popullatës; Mundësitë, investimi në art, mjekësi, kulturë, drejtësi, arsim; Rritja e mirëqënies, rritja ekkonomike, investim nga strukturat përkatëse për shërbimet bazë si shërbimi social, shëndetësor, infrastrukturor, arsimor; Shumë; Kushtet e punës dhe të jetesës; Një të

ardhme që ja vlen për të qëndruar, pagesa më të larta, shërbime më të mira etj; Të kemi liri dhe të drejta të barabarta, vend demokratik, të mbizotërojë meritokracia; Shtimi i vendeve të punës, kushtet e punës dhe meritokracia në vendet e punës, pagat; Niveli i punësimit, gjendje ekonomike, shëndetësore, rritja e taksave e shumë gjëra të tjera;Të vendosen ligje të reja, vende pune, arsimi më i rregullt, ekonomi më të lartë, shëndetësia; Gjithçka fillon nga mënyra e të të menduarit; Kapaciteti i vendeve të punës është i ulët. Edhe n.q.s do kisha mundësi të gjeja një punë në profesionin tim, pagat janë shumë të ulëta; Rritja e rrogave, zhvillimi i sporteve; Çdo gjë; Arsimi, ekonomia, politika, shëndetësia; Çdo gjë në aspektin ekonomik dhe social-kulturor.

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Emigrimi i të rinjve shqiptarë, veçanërisht i elitës së vendit, studentëve, është një nga problematikat më madhore që po has vendi ynë. Studentët shqiptarë po bëhen gjithnjë e më të varfër dhe me mendjen vazhdimisht drejt emigrimit, sa më larg Shqipërisë. Shumica prej tyre duan të emigrojnë dhe një pjesë e vogël prej tyre dëshirojnë të kthehen. Në përfundim të studimit tim, vura re që ka mungesë literature dhe mungesë studimesh për sa i përket çështjes së emigrimit të të rinjve shqiptarë, veçanërisht studentëve. Përsa i përket destinacionit të vendit ku dëshirojnë të emigrojnë, mbizotëron Gjermania, ku çdo ditë e më shumë rritet numri i studentëve (por, jo vetëm), që duan të qëndrojnë atje. Për këtë arsye, mund të vëmë re një numër të madh të rinjsh, që çdo ditë e më shumë zhvillojnë kurse në gjermanisht, me dëshirën për të emigruar atje. Faktori ekonomik është ai që dominon në zgjedhjen për të emigruar jashtë Shqipërisë, por kjo nuk do të thotë që ajo është e vetmja arsye. Shqipëria ka shumë probleme të tjera përveç ekonomisë; është politika, arsimimi, shëndetësia, drejtësia, mungesa e meritokracisë, mosrespektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, ndotja klimaterike, mentaliteti dhe patriarkaliteti shqiptar, mungesa e sigurisë dhe mbrojtjes, korrupsioni i theksuar, nepotizmi, problemet e shumta social-kulturore, etj. Siç shprehen edhe shumica e përgjigjedhënësve të anketës, në Shqipëri duhet ndryshuar pothuajse çdo gjë. Migrimi duhet ndaluar së trajtuari si diçka “e keqe”, sepse ai nuk është shkaktari i problemeve të shumta që përballet vendi ynë, përkundrazi migrimi është si një pasqyrë që reflekton këto probleme. Migrimi është një proçes i pashmangshëm. Ne nuk duhet të përpiqemi t’i ndalojmë studentët që të emigrojnë, por duhet të përpiqemi t’i rregullojmë këto probleme, të ndryshojmë vendin tonë, në mënyrë që rinia të mos largohet, por të qëndrojë dhe të investojë në vendin e tyre, por nëse Shqipëria nuk investon për ta, atëherë ata nuk mund të fajësohen për dëshirën tyre për t’u larguar. Migrimi nuk është një problem, është një proces, një proces i

pashmangshëm. Për të identifikuar sfidat dhe për të tejkaluar problemet e ardhshme që lidhen me të rinjtë, duhet anketuar dhe intervistuar vetë të rinjtë. Duhet bërë përmirësimi i arsimit të lartë dhe atij pasuniversitar. Duhet të hartohen dhe të zbatohen politika që mund të inkurajojnë me sukses kthimin e tyre. Duhet nxitur zhvillimi ekonomik dhe punësimi dhe duhen rritur mundësitë për punësim. Duhen zhvilluar politika sociale dhe shërbime sociale. Të ketë më pak korrupsion, pasurimi i jetës social-kulturore dhe mjedis i pastër. Dr. Ilir Gëdeshi (2020 cit. në Exit Explains, 2020) thotë se *"për të ndryshuar, ne duhet të transformojmë jetën ekonomike, politike dhe sociale."*

- **Shënim:** *Tek llogaritja e fjalëve të lejuara të punimit, nuk është përfshirë faqja e parë (kapaku), bibliografia dhe shtojcat.*

BIBLIOGRAFIA

Anketa e madhe me studentët, 79% duan të emigrojnë. (2021, January 14). Monitor. Retrieved November 1, 2021, from https://www.monitor.al/anketa-e-madhe-me-studentet-79-duan-te-emigrojne/

Ekspertët e INSTAT: Shqipëria, me nivelet më të larta të emigrimit të "trurit". (2021, September 29). AgroWeb. Retrieved November 1, 2021, from https://agroweb.org/ngjarje/ekspertet-e-instat-shqiperia-me-nivelet-me-te-larta-te-emigrimit-te-trurit/

Elezi, E. (2019). *Arsyet e emigrimit tek të rinjtë.* Retrieved November 1, 2021, from https://www.dw.com/sq/arsyet-e-emigrimit-tek-t%C3%AB-rinjt%C3%AB/a-51422743

Gjonca, A., Aassve, A., & Mencarini, L. (2008). Albania: Trends and patterns, proximate determinants and policies of fertility change. *Demographic Research*, *19*, 261–292. Retrieved November 1, 2021, from http://www.jstor.org/stable/26349252

Human capital flight. (n.d.). *Wikipedia*. Retrieved November 1, 2021, from https://en.m.wikipedia.org/wiki/Human_capital_flight

Ikja e të rinjve, fenomeni i largimit është më i lartë në Shqipëri, se kudo tjetër në Europë. (2021, January 22). Monitor. Retrieved November 1, 2021, from https://www.monitor.al/ikja-e-te-rinjve-fenomeni-i-largimit-eshte-me-i-larte-ne-shqiperi-se-kudo-tjeter-ne-europe/

King, R., & Gëdeshi, I. (2020). *The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain?* Retrieved November 1, 2021, from https://www.google.com/url?sa=t&source=web&rct=j&url=http://library.fes.de/pdf-

files/bueros/albanien/17258.pdf&ved=2ahUKEwiip8L22r_zAhWDg_0HHeEpA1YQFnoECAwQAQ&usg=AOvVaw39Wn8Il04xfODe2Ky8vzRr

Mortensen, J. (2008). *Brain Drain and Fragile States*. Retrieved November 1, 2021, from http://www.jstor.org/stable/resrep13108

Ortensi, L. E. (2015). Engendering the fertility/migration nexus: The role of women's migratory patterns in the analysis of fertility after migration. *Demographic Research*, *32*, 1435–1468. Retrieved November 1, 2021, from http://www.jstor.org/stable/26350159

Portes, A., & Celaya, A. (2013). Modernization for Emigration: Determinants & Consequences of the Brain Drain. *Daedalus*, *142*(3), 170–184. Retrieved November 1, 2021, from http://www.jstor.org/stable/43297258

Skeldon, R., Wetenschappelijke Raad voor het Regeringsbeleid, & SCIENTIFIC COUNCIL FOR GOVERNMENT POLICY. (2009). MIGRATION AND DEVELOPMENT: CONTESTED CONSEQUENCES. M. Kremer, P. van Lieshout, & R. Went (Eds.), *Doing Good or Doing Better: Development Policies in a Globalising World* (pp. 321–340). Retrieved November 1, 2021, from http://www.jstor.org/stable/j.ctt46n0g6.18

Student migration. (n.d.). *Wikipedia*. Retrieved November 1, 2021, from https://en.m.wikipedia.org/wiki/Student_migration

The Mass Exodus of Albanian Students and the Impact on the Economy. (2020, December 2). Exit Explains. Retrieved November 1, 2021, from https://exit.al/en/2020/12/02/exit-explains-the-mass-exodus-of-albanian-students-and-the-impact-on-the-economy/

Vracic, A. (2018). *THE WAY BACK: BRAIN DRAIN AND PROSPERITY IN THE WESTERN BALKANS*. Retrieved November 1, 2021, from http://www.jstor.org/stable/resrep21635

Vullnetari, J. (2012). Albanian migration and development. *Albania on the Move: Links between Internal and International Migration* (pp. 59–106). Retrieved November 1, 2021, from http://www.jstor.org/stable/j.ctt6wp6gk.8

Vullnetari, J. (2012). The migration-development nexus. *Albania on the Move: Links between Internal and International Migration* (pp. 35–58). Retrieved November 1, 2021, from http://www.jstor.org/stable/j.ctt6wp6gk.7

Shtojcat

1. Gjinia: femër; mashkull

2. Mosha:

3.Universiteti, fakulteti:

4. Niveli i studimeve tuaja aktualisht:

bachelor viti i parë; bachelor viti i dytë; bachelor viti i tretë; master profesional; master shkencor viti i parë; master shkencor viti i dytë

5. Vendbanimi: qytet; periferi; fshat

6. Banoni në: shtëpinë tuaj; shtëpi me qera; konvikt; të afërmit

7. Me kë banoni: me familjen; me shok/shoqe; vetëm; me të afërm të tjerë; partner/e

8. A jeni aktualisht në marrëdhënie pune: jo; po

9. Sa të kënaqur jeni me jetesën në vendin tuaj: pak i/e kënaqur; aspak i/e kënaqur; i/e kënaqur; shumë i/e kënaqur

10. Cili është plani juaj për të ardhmen: të punësohem jashtë shtetit; të punësohem në Shqipëri; të vazhdoj një cikël tjetër studimesh jashtë shtetit; të vazhdoj kurse ose trajnime jashtë shtetit; të vazhdoj një cikël tjetër studimesh në Shqipëri; të vazhdoj kurse ose trajnime në Shqipëri

11. Cila është arsyeja kryesore e dëshirës tuaj për t'u larguar nga Shqipëria: arsye ekonomike: mundësitë e punësimit në Shqipëri janë të pakta, kostoja e jetesës është shumë e lartë dhe pagat e ulëta; kushtet e punës nuk janë të mira në Shqipëri (paga, siguria); është e vështirë të

gjesh punë në Shqipëri; mendoj që nuk kam të ardhme në Shqipëri; dëshiroj të krijoj një karrierë ndërkombëtare; kërkoj të jetoj në një vend më të sigurt; kërkoj arsim më cilësor/të vazhdoj studime të mëvonshme (specializim, master); të bashkohem me familjen, të afërmit, miqtë, partnerin/en; për të shoqëruar/ndjekur partnerin/en, prindin; për t'u martuar, i/e sapo martuar; kërkoj të jetoj në një vend ku shërbimi shëndetësor të jetë më cilësor; për t'i shpëtuar problemeve familjare; kërkoj të jetoj në një vend më të qëndrueshëm nga aspekti politik; kërkoj të jetoj në një vend më meritokratik; kërkoj të jetoj në një vend ku të drejtat e njeriut respektohen më shumë; për të kaluar një aventurë të bukur

12. Nëse planifikoni të lëvizni/shkoni jashtë shtetit, në cilin vend mendoni të ikni; **13. Cila është arsyeja kryesore që keni zgjedhur këtë vend:** është vend i fuqishëm nga aspekti ekonomik (ka një treg të zhvilluar pune, ofron shumë mundësi për punësim dhe ka paga të larta); kam familjarë dhe të njohur/afërm atje që do më mbështesin; të shoqëroj/ribashkohem me familjen/të shoqëroj/ribashkohem me parterin/en; kam dëgjuar për përvojën pozitive të të tjerëve dhe kërkoj ta provoj vetë; më pëlqen stili i jetesës i atij vendi dhe njerëzit/më pëlqen kultura e atij vendi; njoh gjuhën dhe kulturën e atij vendi dhe e kam më të lehtë të përshtatem; ofrohet arsim cilësor; ofrohet shërbim shëndetësor cilësor; është vend që njihet për mbështetjen sociale/është shtet social; kam siguruar bursë për kohën që do të studio atje; kam siguruar një kontratë pune në atë vend; kam jetuar më përpara në atë vend/kam qenë dikur më përpara në atë vend për një vizitë të shkurtër

14. A keni një plan të caktuar se si do të shkoni jashtë shtetit: kam të afërm jashtë shtetit që do më ndihmojnë/mbështesin/përkrahin; do aplikoj për vizë për arsye punësimi; do aplikoj për vizë për arsye studimi; do aplikoj për llotari; me anë të bursave shtetërore/shkollore; në mënyrë ilegale/të paligjshme/në të zezë; do aplikoj për bashkim familjar; duke aplikuar në programe si

Erasmus ose të tjera të ngjashme; do aplikoj për azil; duke aplikuar në organizata; duke aplikuar për vizë turizmi

15. Cili do të jetë burimi juaj kryesor i financimit për studimet tuaja jashtë shtetit: do të më mbështesin prindërit; do t'i financoj vetë; kam familje, të afërm, miq etj në vendin pritës; do marr hua në bankë; do të më mbështesi partneri/ja; do të më ndihmojë punëdhënësi; do marr bursë nga shkolla/institucion/organizatë/donator; do të më mbështesin të afërm të tjerë; do të më mbështesin miqtë

16. Keni në plan të punësoheni në profesionin tuaj, apo do e ndërroni profesionin: dëshiroj të punësohem në profesionin tim; dëshiroj të punësohem në një profesion tjetër

17. Cili është benefiti kryesor që mendoni se do të arrini pasi të emigroni jashtë shtetit: shtimi/përforëcimi i dijeve të mia akademike dhe profesionale; dhënia e një perspektive në lidhje me karrierën time të ardhshme; të jetuarit jashtë shtetit; zhvillim dhe maturim personal; zhvillimi i një karriere ndërkombëtare; mënyra të reja të të menduarit dhe të sjelljes; të gjitha alternativat; pothuajse të gjitha alternativat e mësipërme; më shumë para; aftësim i gjuhës të vendit pritës; njohuri dhe dije për një shtet tjetër

18. A është në planin tuaj të ktheheni në Shqipëri: nuk mendoj të kthehem në Shqipëri; do të rikthehem në Shqipëri pas një periudhe punësimi jashtë; do rikthehem në Shqipëri për t'u punësuar pasi të përfundoj studimet/trajnimet/kurset

19. Cili është plani juaj afatgjatë: do të ndërtoj një të ardhme në vendin ku dëshiroj të emigroj, duke qëndruar atje përgjithmonë; pasi të kem përmbushur synimet/qëllimet e mia, do rikthehem në Shqipëri; vendin ku dëshiroj të shkoj do e përdor si vend tranzit, që më pas të shkoj diku tjetër

20. Çfarë duhet ndryshuar/bërë që ju të mos ikni, por të qëndroni në Shqipëri: